

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Francis Fukuyama: Inteligjenca artificiale dhe ana e keqe për demokracinë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/francis-fukuyama-inteligjenca-artificiale-dhe-ana-e-keqe-per-demokracine-i584139
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	5 shtator 2026, 14:45:13 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	5 shtator 2026, 16:45:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2860d1b3e8a3e8a864e7317b3a5ac56e4f60b125b1e9e4823b1638c57b44ae4d
TEKSTI	5fff8d04fab14f0af29a5ff4d8f6708cf16276fc216a6cd72f3169291a4c153c
PAMJA	02ebc163239508a5e0538c893512f5f3a30cfb5ab0a952c41c9c7a32394a9ee2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	92d60822ef89ec58b39532b4b7e37670699733a0a3b017ee817e61294d5d154a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	82597d84b51b00d12dc8da6bd19ef563dde476bcf2b8ac3fbaec8c83c315f326
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 46991200
TRANSAKSIONI	0x4a6949f734bb917e86ef48a394a39f5e560c6ca7cb50992564901c0d93c74ab3
IPFS	QmcQ2vpHEy67KT56kkLrEBokuUFGqg7MP3SJ63znFCszpz



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/92d60822ef89ec58b39532b4b7e37670699733a0a3b017ee817e61294d5d154a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 [English](#)

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 [English](#)



1 e [Nis evidentimi i demeve nga zjarri ne Himare, T'avo: Po identifikohen familjet e prekura Putin urdheron armepushim 3-ditor me KievinHinaJ trazon ujerat ne PJ: Do te ka fundit](#)

Francis Fukuyama: Inteligjenca artificiale dhe ana e keqe për demokracinë



5 Shtator 2026, 18:45Bota TEMA



Francis Fukuyama nuk ka frikë ta pranojë kur ka ndryshuar mendje. Teoricieni politik dhe profesori i Universitetit Stanford ka ndryshuar herë pas here gjatë karrierës së tij: në mbrojtjen e pushtimit amerikan të Irakut, në besimin e tij se tregjet e lira prodhojnë në mënyrë të pashmangshme rezultate të mira dhe së fundmi në identifikimin si më pak konservator.

Por, ndoshta mbi kontributin e tij më të madh - esenë e tij të vitit 1989 - e shndërruar në libër, "Fundit i Historisë", e cila popullarizoi idenë se triumfi i demokracisë liberale do të hapte një epokë të re paqeje dhe prosperiteti global pas Luftës së Ftohtë - ai thotë se kritikët e tij kanë gabuar. Duke folur me Reuters nga zyra e tij në Palo Alto të Kalifornisë, Fukuyama sjell mendimet e tij të reja. "Në Mbretërinë e Njeriut të Fundit" është libri më i fundit i tij me kujtime. Aty tregon se çfarë mendon se ka bërë saktë — dhe gabim — në lidhje me "Fundin e Historisë".

Pas një karriere të gjatë në shkencat politike, çfarë ju bëri që ta kthenit objektivin nga vetja?

Epo, kishte disa gjëra. Më është dashur të dëgjoj ankesa për "Fundin e Historisë" dhe ndoshta disa herë në javë dikush që thotë: "Kur do ta tërheqësh atë tezë?" Dhe e gjitha bazohet në një keqkuptim të plotë të asaj që po argumentoja. Nuk e di sa intervista kam bërë gjatë viteve për të provuar ta shpjegoj këtë, por mendova se do ta shprehja argumentin drejtpërdrejt.

Gjëra tjetër është se 20 vitet e fundit ose më shumë të karrierës sime kanë pasur një fokus shumë të ndryshëm. Jam interesuar shumë për vetë shtetin: burokracinë, mënyrën se si qeveritë ofrojnë shërbimet bazë. Në politikën amerikane, ajo është në plan të parë sepse Donald Trump dëshiron të shkatërrojë atë që ai e quan "shteti i thellë". Argumenti im është se shteti i thellë është absolutisht i nevojshëm për çdo formë të qeverisjes moderne dhe doja të shpjegoja saktësisht se si arrita në këtë sërë përfundimesh.

Titulli i kujtimeve tuaja i referohet esesë suaj "Fundi i Historisë", e cila u bë burim për një lloj triumfalizmi që thoni se nuk e keni menduar kurrë. Çfarë donit të thoshit?

"Fundi i Historisë" nuk është fraza ime. Ishte një frazë e filozofit gjerman Georg Hegel, filozofi i parë historicist që besonte se ekzistonte një histori e përgjithshme progresive në historinë njerëzore.

Fundi i historisë nuk ishte ndërprerja e ngjarjeve; në të vërtetë ishte qëllimi ose drejtimi i historisë. Ne kemi përjetuar një lloj historie progresive gjatë 40,000 viteve të fundit dhe kemi parë ngritje të formave të ndryshme të organizimit shoqëror. Dhe pyetja është: ku çon kjo? Marksistët e përdorin gjithashtu shprehjen "fundi i historisë", por fundi i tyre i historisë ishte komunizmi.

Arsyeja pse e shkrova artikullin origjinal në vitin 1989 ishte (sepse) po bëhej shumë e qartë se Bashkimi Sovjetik nuk do të arrinte kurrë atje - dhe, nëse do të kishte një fund të historisë, do të ishte faza para kësaj, e cila ishte një kombinim i demokracisë dhe ekonomisë së tregut. Ky ishte argumenti im që nga fillimi.

Pjesa që mendoj se njerëzve u ka shpëtuar ishte se titulli i librit ishte "Fundi i Historisë dhe Njeriu i Fundit". Njeriu i fundit, përsëri, nuk është fraza ime. Ishte një nga filozofi Friedrich Nietzsche, i cili në thelb tha se në fund të historisë, do të keni këtë krijesë që ai e etiketoi me tallje njeriun e fundit që nuk kishte aspirata sepse lufta historike kishte përfunduar.

Argumenti që po bëja në atë libër ishte se njerëzit nuk duan të jenë burrat ose gratë e fundit; se nuk do të kënaqen vetëm me paqen dhe prosperitetin, të cilat janë ato që na ka sjellë rendi ynë aktual liberal. Ata duan të luftojnë për hir të një lufte. Nëse njerëzit nuk mund të luftojnë për demokracinë dhe të drejtat e njeriut sepse kjo fitore është fituar në një brez të mëparshëm, atëherë ata do të luftojnë kundër demokracisë sepse ajo që duan të bëjnë është të luftojnë. Dhe mendoj se kjo shpjegon shumë nga populizmi dhe pakënaqësia që shihni si në të majtën ekstreme ashtu edhe në të djathtën ekstreme sot.

Ju shkruani hapur rreth gabimit që bëtë publikisht me ndarjen nga neokonservatorët e tjerë për shkak të Irakut. Si është të mohosh ata që ju ndihmuan të formoheni?

U ndava me disa nga miqtë e mi të hershëm për shkak të kësaj. Ata ndaluan së foluri me mua për një periudhë prej 15-20 vjetësh pasi ndodhi kjo. Por është diçka me të cilën mund të jetoja mjaft lehtë sepse kisha miq të tjerë; kisha rrethe të tjera shoqërore që mund të ndiqja. Më tregoi sa e vështirë është në të vërtetë të pranosh se je gabim. Politikanët e urrejnë ta bëjnë këtë. Do të doja të ishin të sinqertë për këtë.

Ju shkruani se si përmbyjsja e situatës në Irak ju detyroi të rimendoni tema të tjera. Cila është gjëja më e fundit për të cilën keni ndryshuar mendje?

Nuk e konsideroj më veten shumë konservator — dhe mendoj se kjo nuk ndodhi vetëm si përgjigje ndaj luftës në Irak, por edhe ndaj krizës financiare të vitit 2008, sepse konservatorizmi amerikan në fillim të viteve 2000 u ndërtua rreth një politike të jashtme muskuloze dhe një besimi se tregjet e lira do të ishin vetëkorrigjuese dhe vetëmbështetëse. Dhe doli që asnjëra prej këtyre nuk ishte e vërtetë. Të dyja çuan në fatkeqësi të mëdha për politikën e jashtme amerikane dhe për ekonominë amerikane dhe globale, dhe rreth vitit 2010 më dukej vërtet se këto dy ide themelore konservatore ishin thjesht të gabuara.

Në atë kohë, jepja mësim në Johns Hopkins, drejtoja një program zhvillimi ndërkombëtar dhe më ishte mjaft e qartë se një pjesë e madhe e axhendës tradicionale socialdemokrate ishte në të vërtetë ajo që kishte mbështetur stabilitetin e shumë demokracive moderne në një kohë kur shumë konservatorë argumentonin një politikë shumë të rreptë neoliberale: të mos i jepej askujt lëmoshë, të mos bëhej rishpërndarje sepse kjo do të dëmtonte të drejtat e pronës e kështu me radhë, kështu që ka ide të tjera që binin ndesh në atë periudhë.

A mendon se është më e vështirë të ndryshosh mendje sot sesa në të kaluarën? A është shoqëria mjaftueshëm tolerante kur njerëzit e bëjnë këtë?

Sigurisht, në Shtetet e Bashkuara, shkalla e polarizimit është aq e thellë sa është vërtet e vështirë të ndryshosh mendje. Zgjedhjet amerikane përqendrohen rreth popullatave shumë të vogla të votuesve të pavendosur që mund të bindeshin të votonin për partinë tjetër, por me çdo vit që kalon, numri i votuesve të tillë zvogëlohet.

Polarizimi ynë tani është ajo që shkencëtarët socialë e quajnë "polarizim afektiv", ku thjeshtë nuk pajtohesh me politikën - në të vërtetë nuk i beson në mënyrë aktive palës tjetër. Po të marrim parasysh këtë element shumë personal, mendoj se kjo është një pengesë e madhe për diskursin, për të qenë në gjendje të diskutojmë në mënyrë racionale çështje të diskutueshme. Kjo duhet të jetë baza për të ndryshuar mendjen, dhe mendoj se kjo është bërë shumë më e vështirë në SHBA sot.

I gjithë rrëfimi juaj i historisë bazohet në dëshirën për njohje, e cila në një farë mënyre është shumë njerëzore. Ndërsa u japim më shumë punë dhe pushtet agjentëve të inteligjencës artificiale, a mbijeton kjo kornizë? Çfarë ju shqetëson më shumë?

Unë mendoj se inteligjenca artificiale ka të ngjarë të jetë shumë e keqe për demokracinë për një sërë arsyes. Ndikimi ekonomik i saj do të godasë shumë njerëz të klasës së mesme që kanë vende pune krejtësisht të respektueshme tani, por ato do të automatizohen. Do të përqendrojë pasurinë te njerëzit që krijojnë këto makina, dhe ne po e shohim këtë tashmë.

Do të ngrejë këto pyetje interesante dhe shqetësuese rreth asaj që do të thotë të jesh njeri, sepse do të kesh makina që do të jenë në gjendje, nga jashtë, të kopjojnë shumë nga sjelljet e një qenieje njerëzore të vërtetë. Nëse kjo dëmton ndjenjën tonë të dinjitetit tonë, kjo është gjithashtu një mundësi dhe një rrezik. Unë me të vërtetë mendoj se kjo do të jetë sfida e madhe e brezit të ardhshëm.

Libri mbyllet me të ardhmen e demokracisë liberale. A ka ndonjë çështje që ende e ndiqni, apo një që nuk i jeni përgjigjur në mënyrë të kënaqshme?

Njëra prej tyre ka të bëjë me proceduralizmin, sepse një regjim liberal është ndërtuar mbi sundimin e ligjit. Dhe duket sikur çdo regjim liberal thjesht grumbullon rregulla pa fund, deri në atë pikë sa bëhet shumë e vështirë për të që të arrijë gjëra të tilla si ndërtimi i infrastrukturës (ose) marrja e vendimeve të rëndësishme. Nuk e kam të qartë nëse ky proces mund të moderohet ose të përmyset, dhe mendoj se duhet të përmyset nëse do të ndjekësh vërtet lloje të caktuara qëllimesh kolektive.

E fundit është diçka që e ngrita për herë të parë në librin që botova në vitin 2000, "E ardhmja jonë post-njerëzore", që përqendrohej në bioteknologji. Tani keni pasur këtë bashkim të teknologjisë së informacionit dhe bioteknologjisë ku mund të filloni të manipuloni disa gjëra shumë të thella në natyrën njerëzore dhe mund të përdorni inteligjencën artificiale për t'ju ndihmuar ta bëni këtë. Dhe pyetja është: Sa nga kjo liri duam vërtet të ushtrojmë? A duam vërtet të jemi në gjendje të ndryshojmë disa gjëra të rëndësishme të thella në lidhje me atë që e konsiderojmë si natyrën tonë? Nëse po, kjo do të ketë pasoja të rëndësishme për gjëra të tilla si të drejtat e njeriut, sepse besoj se kuptimi ynë i të drejtave të njeriut është i rrënjosur në supozimet që bëjmë për atë që është e rëndësishme për qeniet njerëzore si specie. Këto janë disa nga gjërat për të cilat shqetësohem.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Putin urdhëron armëpushim 3-ditor me Kievin

16:35 Bota

"Përvëlohet" Spanja: Shtatori nis ndryshe në Europë, vera nuk po largohet!

16:05 Bota



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.